



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:155523  
Datë: 12.03.2024  
Numri i dokumentit: 05441311

**SCC-10-0337**

*Paditësit*

**D (Sh) L1, D (Sh) L2 – Fshati D, Kaçanik.**  
*Përfaqësuar nga Daut Rudi avokat nga Kaçaniku.*

*Kundër*

*Të paditura*

**Kooperativa Bujqësore “Shtërpce” përfaqësuar nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit – AKP, “Dritan Hoxha” nr.55, Prishtinë.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Hajrije Shala gjyqtare kryesuese dhe gjyqtarët Bajram Miftari dhe Diellza Hoxha anëtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me dt.12 mars 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.REFUZOHET si e pa bazuar** kërkesëpadia e paditësve D L1 dhe D L2 me të cilën kanë kërkuar të vërtetohet se paditësit si trashëgimtar të të ndjerit Sh L, janë pronar në pjesë ideale prej ½ të: parcelat kadastrale nr...me kulturë livadh klasa 5 në sipërfaqe prej 2252 m2, parcelën kadastrale nr.77-0 me kulturë mal klasa 2 në sipërfaqe prej 59532, parcelën kadastrale nr.78-0 me kulturë livadh klasa 5 në sipërfaqe prej 1000m2, parcelën kadastrale nr... me kulturë mal klasa 2 në sipërfaqe prej 3242m2, parcelën kadastrale nr.106-0 me kulturë livadh klasa 5 në sipërfaqe prej 264m2, parcelën kadastrale nr... me kulturë arë klasa 5 me sipërfaqe prej 4301m2, parcela kadastrale nr... me kulture mal klasa 2 në sipërfaqe prej 645m2 si dhe parcela kadastrale nr... me kulturë livadh klasa 5 me sipërfaqe prej 01.23.55m2, të gjitha këto parcela në vendin e quajtur “Ç” në sipërfaqe të tërësishme prej 03,00.12 ha, ZK S, Komuna e Kaçanikut, sipas Certifikatës së pronës UL-.....

## **II.Paditësi nuk ngarkohet me taksë shtesë.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.22 nëntor 2010 pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme është dorëzuar padia për vërtetimin e pronësisë lidhur me parcelat kadastrale nr.. në sipërfaqe prej 00.22.52 ha, me kulturë livadh, parcelën kadastrale nr... në sipërfaqe prej 00,59.53 ha me kulturë mal, parcelën kadastrale nr... në sipërfaqe prej 00.10.00 me kulturë livadh, parcelën kadastrale nr... ne sipërfaqe prej 00.32.42ha me kulturë mal, parcelën kadastrale nr... në sipërfaqe prej 00,02.64ha me kulturë livadh, parcelën kadastrale nr... me sipërfaqe prej 00,43.01 me kulturë arë, parcela kadastrale nr... në sipërfaqe prej 00,06,45 me kulture mal dhe parcela kadastrale nr... me sipërfaqe prej 01.23.55ha me kulturë livadh, të gjitha këto parcela gjenden në vendin e quajtur “Ç M” në sipërfaqe e përgjithshme 03.00.12ha, ZK S, Komuna e Kaçanikut.

Paditësit kanë theksuar se në fillim të vitit 1962 Organet Shtetërore të atëhershme këtë pasuri private të babait të tyre, pa bazë juridike dhe në mënyrë të kundërligjshme e kanë bartur në emër të pasurisë shoqërore në Kooperativën Bujqësore “Ramadan Agushi” në Kaçanik dhe pastaj në emër të paditurës së dytë “Mlladost” Shtërpce dhe se për këtë e kishte dhënë pëlqimin Komuna e Kaçanikut, për shkak nevojave agrare.

Paditësit kanë propozuar që të aprovohet kërkesëpadia dhe të vërtetohet se paditësit janë bashkëpronarë në pjesë të barabarta në ½ e pjesëve ideale të paluajtshmerisë të shënuara në ekstrat nga fletë posedimi nr... i dt... ZK S K. Kaçanikë dhe të Detyrohet e paditura e parë që ta pranoj dhe të lexoj që kjo paluajtshmëri në Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi në K. Kaçanikë të regjistrohet në emër të paditësve dhe poashtu tua kompensoj shpenzimet e procedurës.

Së bashku me padi janë bashkëngjitur: certifikatën e vdekjes së trashëgimlënësit Sh L me numër V..., certifikata e lindjes e D L me numër L..., certifikata e lindjes e D L me numër L..., Fletën poseduese me nr... të dt. ..dhe ekstrakti nga fletëposedimi me nr...e dt...,të lëshuara nga Drejtoria Komunale e Gjeodezisë në Kaçanik.

Gjykata me dt.02 dhjetor 2010 ka lëshuar një urdhër për paditësit me anë të së cilit ka kërkuar nga të njëjtit që në afat ligjor të bëjnë dorëzimin e provave materiale me të cilat i mbështesin pretendimet e tyre, hollësi të sakta se si është transferuar prona, hollësi të sakta se si ka ardhur prona në pronësi të paraardhësve të tyre si dhe aktvendimin e trashëgimisë. Paditësi D L e ka pranuar urdhërin, por nuk i është përgjigjur të njëjtit.

Me dt.20 prill 2023, e paditura AKP ka parashtruar përgjigjen në padi me të cilën i kundërshton pretendimet e paditësit të paraqitura në padinë e tij, duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. AKP-ja konsideron se paditësi ka parashtruar padinë në kundërshtim me parimin procedural – Legitimacio ad causam, i cili ka të bëjë me legjitimitetin real aktiv të palës. AKP konsideron se paditësit nuk kanë legjitimitet real aktiv për me qenë palë ndërgjyqëse në këtë çështje

juridike, pasi që nuk kanë paraqitur asnjë dëshmi të ndonjë vendimi gjyqësor – Aktvendim për Trashëgimi sipas nenit 171.1 të Ligjit për procedurën jo kontestimore, me të cilin paditësit janë shpallur trashëgimtarë ligjor të paraardhësit të tyre. Në fund e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia të refuzohet si e pa bazuar.

Me dt.25 prill 2023, gjykata lëshoj urdhër për paditësit duke kërkuar Aktvendimin e trashëgimisë. Me dt.19 maj 2023, paditësi ka dorëzuar një kopje të vendimit të trashëgimisë të lëshuar në ish Gjykatën Komunale në Ferizaj T.nr. 104/75 i dt. 09.07.1975.

I autorizuari i paditësve me dt.18 janar 2024 ka bërë dorëzimin e një parashtrese përmes të cilës ka bërë plotësimin dhe precizimin e kërkesëpadisë, duke bërë tërheqjen e padisë ndaj Komunës së Kaçanikut, ashtu që tani e tutje si e paditur mbetet vetëm P.SH “Koperativa Shtërpce” të cilën e përfaqëson AKP-ja.Poashtu ka theksuar se paditësit me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Kaçanikë T.nr.104/75 janë shpallur trashëgimtar të të ndjerit Sh L me nga ½ të pjesës ideale të trashëgimisë, me çka dëshmohet legjitimiteti aktiv i tyre në procedurë. Me reformën agrare të viteve 1928-1932 mbretëria serbe ua ka shpronësuar këto paluajtshmëri në baza diskriminuese dhe ua ka dhënë në shfrytëzim kolonëve serbo-malazezë. Gjatë vitit 1944 të njëjtit janë larguar nga Kosova dhe pronarët legjitim prapë i kanë marr në pronësi paluajtshmërit. Komisioni komunal për shqyrtimin e çështjeve pronësore juridike i Këshillit Popullor të Kaçanikut ka marr aktvendim nr.1033 dt.24.04.1962, me të cilin shumë pronarëve në mesin e tyre edhe paraardhësit të paditësve ua ka mohuar të drejtën e pronësisë dhe ka bërë uzurpim të pronës shoqërore në sipërfaqe të tërësishme prej 3,22.00m<sup>2</sup>. Meqenëse ky aktvendim nuk është bërë i plotëfuqishëm atëherë paraardhësi i paditësve ka ushtruar Revizion. Paluajtshmëritë sipas shënimeve kadastrale kanë qenë të evidentuar në emër të paraardhësit të paditësve Sh L deri në vitin 1966.

Me dt.19.10.1962 derisa çështja ishte në procedurë mes përfaqësuesve të K. Kaçanikut, KB “Ramadan Agushi” dhe KBI “Kosmet Export” është nënshkruar kontrata mbi bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë bujqësore nr.8071 dt.19.10.1962 me të cilën edhe paluajtshmëritë e paraardhësit të paditësit kanë kaluar pa bazë ligjore dhe pa kompensim në emër të KBI “Kosmet Export”. Duke vepruar sipas revizionit të paraardhësit të paditësve me dt.15.08.1970 Komisioni për Shqyrtimin e marrëdhënieve pronësore juridike pranë KK Kaçanikë, është përcaktuar se Sh L i njihet e drejta e pronësisë në parcelat e përshkruara për arsye se nuk kemi të bëjmë me uzurpim arbitrar të pasurisë. Po ashtu me aktvendimin nr.04-1884/67 dt.15.10.1971 është anuluar aktvendimi me të cilin janë marr paluajtshmëritë dhe paditësit i është njohur e drejta e regjistrimit formalisht në emër të tij. Në vitin 1992, organet serbe pasurinë e KBI “Export Import” e kanë bartur në emër të “Zadruga Shtërpce” ose tani P.SH “Kooperativa Shtërpce”, ashtu që tani paluajtshmëritë kontestuese evidentohen në emër të paditurës.

Tutje në parashtresë ka kërkuar që të miratohet padia dhe kërkesëpadia e paditësve dhe të Vërtetohet se paditësit si trashëgimtar të të ndjerit Sh L, janë pronar në pjesë ideale prej ½ të: parcelat kadastrale nr...me kulturë livadh klasa 5 në sipërfaqe prej 2252 m<sup>2</sup>, parcelën kadastrale nr.77-0 me kulturë mal klasa 2 në sipërfaqe prej 59532, parcelën kadastrale nr... me kulturë livadh klasa 5 në sipërfaqe prej 1000m<sup>2</sup>, parcelën kadastrale nr... me kulturë mal klasa

2 në sipërfaqe prej 3242m<sup>2</sup>, parcelën kadastrale nr... me kulturë livadh klasa 5 në sipërfaqe prej 264m<sup>2</sup>, parcelën kadastrale nr... me kulturë arë klasa 5 me sipërfaqe prej 4301m<sup>2</sup>, parcela kadastrale nr... me kulture mal klasa 2 në sipërfaqe prej 645m<sup>2</sup>, si dhe dhe parcela kadastrale nr... me kulturë livadh klasa 5 me sipërfaqe prej 12355m<sup>2</sup>, respektivisht në sipërfaqe të tërësishme prej 30,012.00m<sup>2</sup>, ZK S, Komuna e Kaçanikut, sipas Certifikatës së pronës UL-....

Kësaj parashtrese i ka bashkangjitur këto prova: Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Kaçanikë T.nr.104/75 dt.19.07.1975, Aktvendimin nr.1038 dt.25.04.1962, Fleta poseduese nr... dt...., Kontrata mbi bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë bujqësore, Revizioni, Procesi mbi shqyrtimin verbal me përfundimin e dt.15.08.1970 nga Komisioni Komunal i Kaçanikut, Aktvendimi nr.04-1884/67 dt.15.10.1971, Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme 06 nr.... nr. certifikatës UL-.....

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e dt.07.02.2024, ku kanë prezantuar përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse.

Në shqyrtimin gjyqësor i autorizuari i palës paditëse mbeti pranë padisë dhe parashtresës të dorëzuar gjykatës me dt. 18.01.2024 për precizimin dhe plotësimin e padisë, të cilës i ka bashkëngjitur provat e nevojshme. Po ashtu theksoi se me parashtresë ka njoftuar gjykatën se kanë bërë tërheqjen e padisë ndaj Komunës së Kaçanikut dhe tani e tutje e paditur është vetëm Kooperativa Bujqësore “Shtërpce” përfaqësuar nga Agjencinë Kosovare i Privatizimit – AKP. Fillimisht nuk ka pas shpronësim e as procedurë të shpronësimit por, me vendim të Këshillit të atëhershëm Komunal të vitit 1962 është shpallë uzurpator mandej, kanë bërë revizion. Ndaj këtij vendimi në të cilin paraardhësi i paditësit ka parashtruar revizion i cili ka qenë mjet i rregullt juridik në atë kohë por ,që ky revizion është shqyrtuar tek mbas ndryshimit të klimës politike në Kosovë respektivisht pas viteve 70 - ta ashtu që duke vepruar sipas revizionit Komuna e Kaçanikut ka formuar një komision për shqyrtimin e marrëdhënieve pronësore juridike i cili komision pas dëgjimit të dëshmitarëve siç janë shkresat që i janë bashkëngjitur parashtresës ka ardh në përfundim me dt. 15.08.1970 me të cilin Sh L i njihet e drejta e pronësisë në parcelat e përshkruara për arsye se nuk kemi të bëjmë me uzurpim arbitrar të pasurisë. Dhe po ashtu me aktvendimin nr. 1884/67 të dt. 15.10.1971 komisioni lejon revizionin e parashtruar ndërsa, me piken 2 hidhen poshtë fletëparaqitjet mbi uzurpimin arbitrarë të paluajtshmërive përveç tjera duke konstatuar ky komision në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me përvetësim të pronës por, si paluajtshme objekti i këtij vendimi ka qenë prona para vitit 1928 e personit ndaj të cilit është ushtruar fletëparaqitja pra para rastit të paditësve. Sa i përket pretendimit se është tërheq padia ndaj komunës së Kaçanikut, Komuna mban vetëm evidencë kadastrale dhe juridiksioni i kësaj gjykate është i caktuar me nenin 5 të Ligjit të DHPGJSK-së dhe po ashtu praktikat e kësaj gjykate në këtë rast komuna edhe pse ka qenë palë deri në fund, as kolegji i shkallës së dytë nuk e ka marre për baze këtë fakt deri në përfundim të procedurës. AKP-ja, është menaxhuese e pronave shoqërore dhe se padia ushtrohet ndaj pronarit i cili formalisht evidentohet ne ZK e qe në këtë rast ZK-ja mban vetëm evidence kadastrale te pronës. Sa i përket revizionit se a është i plotfuqishëm, po te kishte klauzolën e plotfuqishmërisë nuk do të zhvillohej ky proces.

Përfaqësuesi i AKP-së ka deklaruar se mbetet pran kundërshtimeve të më hershme, konsideron se padia edhe me precizimin e padisë është e pa themeltë në kuptim të nenit 399.2 të LPK-së për faktin se shpronësimi është bërë nga Komuna ndërsa, paditësi e ka tërheqë padinë pikërisht ndaj Komunës. Për rrjedhojë NSH-ja nuk ka pas kurrfarë raporti juridik me paditësit dhe nuk ka kurrfarë përgjegjësie në raport me të, gjithashtu duke ju referuar revizionit, nuk jemi në dijeni se ky revizion është i plotfuqishëm. Me këshillë juridike ka pas të drejtë ankesë, ne nuk e kemi vendimin e plotfuqishëm të këtij vendimi andaj, kufizohemi edhe ne përgjigje. Lidhur me shpronësimin që e kundërshtoi pala vendimi në fjalë është lëshuar siç ka cekur vet pala nga Komisioni Komunal për shqyrtimin e çështjeve pronësorë juridike të Këshillit Popullor të Kaçanikut dhe ka marrë vendimin nr.1033 të dt.25.04.1962 me të cilin paraardhësi të paditësve ju ka mohuar e drejta e pronësisë. Kurse, lidhur me revizionin edhe pala e konfirmoj që nuk ka titull juridik dhe pretendimi i tij mbi këtë titull është i pa bazuar aq me tepër kur nuk është edhe gjithë dosja e lendes se çka është vendos me këtë revizion kur ka pas të drejte ankese. Në çdo rrethane edhe po të ishte e kundërta në kuptim të nenit 268 Ligji i punës se bashkuar e drejta e pronës afati maksimal kërkohet brenda 10 vitesh edhe mbi këtë baze paditësi nuk e gëzon të drejtën e pretenduar.

Me dt.16.02.2024, i autorizuari i palës paditëse ka paraqitur fjalën përfundimtare ku ka deklaruar se në këtë procedurë dhe në bazë të provave është dëshmuar legjitimiteti aktiv i paditësve, ashtu sikurse edhe legjitimiteti pasiv i palës së paditur. Tutje ka shtuar se është dëshmuar edhe fakti se paraardhësi i paditësve ka qenë pronar i parcelave kontestuese deri në vitin 1964, e që me aktvendimin nr.1038 dt.25.04.1962 është shpallur uzurpues i pronave. Pra, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me shpronësim, siç pretendon pala e paditur. Pasi që paraardhësi i paditësve nuk është pajtuar me aktvendimin që është shpallur uzurpues dhe revizioni i tij është aprovuar me aktvendimin nr.1884/67 dt.15.10.1971 ashtu që aktvendimi i atakuar është anuluar. Ky aktvendim është bërë i formës së prerë dhe ndaj tij nuk është ushtruar ankesë. Sa i përket pretendimit të të paditurës se kërkesa është parashkuar, Ligji i punës së bashkuar nuk përmban asnjë dispozitë ligjore sipas të cilit ky ligj do të mund të aplikohet në rastet e vitit 1962. Me të gjitha provat është vërtetuar pa mëdyshje se paraardhësve të paditësve pa kurrfarë baze juridike i janë marr paluajtshmëritë dhe akti juridik me të cilin është shpallur uzurpues e ka humbur vlerën juridike.

Pala e paditur me dt.13.02.2024 ka paraqitur fjalën përfundimtare ku ka pohuar se mbetet pranë kundërshtimeve të saja të paraqitura paraprakisht. Aktvendimi nr.1033 dt.25.04.1962 nuk është i lexueshëm dhe nuk përmban fq.2, apo pikën 8 sa i përket çështjes së paditësve. Padia e paditësit është e pa themeltë në kuptim të nenit 399.2 të LPK pasi që padia është në kundërshtim me provat e prezantuara, sepse paditësit e kanë tërhequr padinë ndaj Komunës së Kaçanikut dhe pikërisht është komuna ajo që e ka bartë pronën të e paditura dhe si rrjedhojë e paditura nuk ka krijuar marrëdhënie juridike me paditësit. Andaj, edhe tërheqja e padisë ndaj K. Kaçanikut është bërë qëllimisht për të vënë në lajthim gjykatën. Prandaj, sipas të paditurëspadia është e pa bazuar dhe nuk është argumentuar pretendimi i paditësve, shpronësimi ka qenë kompetencë e organit shtetëror, kurse ajo me vendim ia ka bartë të drejtën e pronësisë apo shfrytëzimit tek NSH-ja, nga kjo vërtetohet se NSH-ja e ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të nenit 20 të LMTHPJ, e si bazë juridike ka përmendur nenin 45 të

LMTHPJ. Në bazë të nenit 268 të Ligjit për Punën e Bashkuar parashihet se: nëse patundshmëria është bërë pronë shoqërore pa bazë juridike, kthimi i së njëjtës mund të kërkohej në afat prej 5 viteve, duke filluar nga dita e marrjes në dijeni, por më së voni në afat prej 10 viteve. E në këtë çështje nuk është kërkuar kthimi brenda këtij afati ligjor. Andaj ka kërkuar që të refuzohet kërkesëpatria e paditësve si e pabazuar.

### **Arsyetimi ligjor**

Kolegji gjykues i Dhomës së Posaçme, pas shqyrtimit të përgjithshëm të padisë, dokumenteve dhe provave të mbledhura gjatë gjithë procedurës me shkrim, administrimit të tyre një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën, vjen në përfundim se patria është e pabazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)”*, ndërsa pika 3 parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.”*

Gjykata pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të lartëcekura dhe thënieve të palëve ndërgjyqëse, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe gjeti se , pretendimet e paditësit se e ka humbur pronësinë me regjistrimet e vitit 1962, janë të pa bazuara dhe të pa vërtetuara. Andaj, e paditura në mbrojtje me të drejtë ka theksuar se paditësi nuk ka prezantuar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimet e tij se e ka humbur të drejtën e pronës në ngastrën kontestuese. Kjo për faktin se e drejta e pronësisë është e drejtë subjektive e karakterit absolut dhe si e tillë gëzon mbrojtje juridike në të gjitha sistemet juridike dhe se për sendet e paluajtshme të cilat janë të regjistruara në librat kadastrale, vlen supozimi se sendi është në pronësi të personit në emër të të cilit është e regjistruar mirëpo, edhe nëse paluajtshmëria nuk është e regjistruar në emër të atij që kërkon pronësinë, i njëjti para gjykatës ka për detyrë të paraqes veprimet e ndërmarrura dhe pengesat e hasura për të argumentuar se i takon ajo e drejtë, gjë që paditësi nuk arriti ta bëjë.

Në këtë rast e paditura kundërshtoi faktet e palës paditëse në rastin kur theksoi se kërkesa e paditësit sipas revizionit është aprovuar me aktvendimin nr.1884/67 dt.15.10.1971 dhe aktvendimi i atakuar është anuluar. Pastaj se, ky vendim është bërë i formës së prerë pasi që ndaj tij nuk është ushtruar ankesë. E paditura këto kundërshtime i arsyetoi me faktin se

gjykatës nuk i janë ofruar prova që dëshmojnë ndërmarrjen e veprimeve për bartje të pronësisë.

Gjykata gjeti se kundërshtimet e të paditurës janë të bazuara ndërsa, sa i përket pretendimeve të paditësve të njëjtat nuk qëndrojnë, për faktin se edhe pse kopja e këtij vendimi përmban vulën e saktësisë dhe të plotëfuqishmerisë, nuk mund të konstatohet se ky vendim kishte marr një epilog ka marr sepse, të paditurit me asnjë provë nuk kanë argumentuar se kanë ndërmarr ndonjë veprim në drejtim të pretendimeve të tyre për kthim të pronës kontestuese.

Çështje tjetër kontestuese për gjykatën ishte se në shkresat e lëndës është bashkangjitur edhe kopja kontratës e dt..., e lidhur në mes të Kombinatit Bujqësor në Kaçanik, KBI “ Kosmet – Eksport “ Prishtinë dhe Komunës së Kaçanikut, për bartjen në shfrytëzim të sipërfaqeve të tokave bujqësore ashtu që, nën numrin rendor 5 janë marr në shfrytëzim tokat në vendin e quajtur “M J“ në ZK S e në sipërfaqe prej 84 ha 29 ari e 50 m<sup>2</sup> . Ndërsa, në pikën 9 të kontratës është obliguar që KBI “Kosmet –Eksport“ Kaçanik që menjëherë të filloj me krijimin e kompleksit të tokave të cilat janë objekt i kontratës përmes kompenzimit apo arondimit, gjithëherë duke respektuar interesin ekonomik të “ Kosmet –Eksportit. “ Por këtë fakt paditësit asnjëherë nuk e ka përmendur për të vërtetuar se janë komenzuar apo jo, për marrjen e pronave nga KBI “Kosmet –Eksport“ Kaçanik.

Pastaj në fletën poseduese nr. ..e dt. ...e lëshuar nga Komuna e Kaçanikut ZK S janë evidentuar të dhënat se Sh B L ishte posedues i .. palujtshëmërive në vendin e quajtur M në sipërfaqe prej 3,00.12 ha por, vetëm deri në vitin 1966.

Po me të njëjtën datë nga Komuna e Kaçanikut është lëshuar edhe fleta poseduese nr. 106 ZK S për sipërfaqen prej 3.00.12 ha e cila evidentohet në emër të P.SH. Kooperativa “Shtërpçë “.

Pra, fleta poseduese nr. ..e dt. .... është lëshuar në emër të Sh B L ndërsa, vendimi nr.04-1884/67 i referohet Sh R L, dallim të cilin paditësit nuk e sqaruan për të marr një përfundim se kemi të bëjmë me trashëgimlënësin e njëjtë.

Gjykata, poashtu vlerësoi edhe vendimin nr. 04-1884/67 I dt.15.10.1971 i lëshuar nga komisioni për vlerësimin e pronës të krijuar nga marrja (uzurpimi) i tokave nga prona shoqërore pran Kuvendit Komunal të Kaçanikut i cili kishte arritur në konkludimin për aprovimin e revizionit të vendimeve të plotëfuqishme nr. 1038 të dt. 25.04.1962 për shqyrtimin e pronave respektivisht marrjeve vetanake të pronave në pronësi shoqërore që i referohet Sh R L nga D ashtu që, ky vendimi me të cilin ishte shpallur uzurpator, ishte anuluar me revision.

Përkundër faktit se sipas paditësve, ishte aprovuar revizioni duke u anuluar vendimi i dt. 25.04.1962 sa i përket trashëgimlënësit Sh L i njëjti më tutje nuk kishte ndërmarr asnjë veprim të vetëm në drejtim të pretendimeve të tij për kthim të pronave, poashtu edhe trashëgimtarët e të njëjtit deri në vitin 2010 kur e kanë ushtruar padinë, nuk e kishin drejtuar kërkesën e tyre tek asnjë organ kompetent.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës paditëse në lidhje me objektin e kontestit por, të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje, pasi që gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e paditësve lidhur me të drejtën e tyre në vërtetim të pronësisë në parcelat kontestuese, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Gjykata vendosi të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë gjeti se pronat kontestuese evidentohen në pronësinë shoqërore, konkretisht evidentohet në emër të të paditurës.

Andaj nga sa u tha më dhe në pajtim me nenin 54.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Paditësi e ka paguar taksën gjyqësore për padinë e parashtruar.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Hajrie Shala, Gjyqtare kryesuese**

**Bajram Miftari, Gjyqtar**

**Diellza Hoxha, Gjyqtar**